



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1262/6 prot.

Datë 21/05/2026

V E N D I M
Nr. 684/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 21/05/2026, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “SOHO SOLUTIONS” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-79360-03-17-2026, me objekt: “Auditim i Brendshëm i ISMS sipas Standartit ISO 27001:2022”, me fond limit 1,733,333.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 30-03-2026, nga autoriteti kontraktor, Identitek Sh.a.

Ankimues: Operatori ekonomik “SOHO SOLUTIONS” SHPK, me NIPT (M41902005D) dhe adresë Njësia Administrative Nr.5, Rruga Ukraina e Lirë , Pallati Nr.1, Kati 1, Apartamenti Nr.4.

Autoriteti Kontraktor: Identitek Sh.a, me adresë: Rr. “Xhanfize Keko”, Ndërtesa nr. 111, Hyrja nr.1, Tiranë.

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020, datë 05.11.2020 “Rregullore për marrjen e masave organizative për ushtrimin e veprimtarisë së institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi kërkesën e ankimuesit dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I****Vlerësimi paraprak**

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimarrja do të bëhet nga 3 (tre) anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar si dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II**Rrethanat e çështjes**

II.1. Në datën 18-03-2026, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-79360-03-17-2026, me objekt: "Auditim i Brendshëm i ISMS sipas Standartit ISO 27001:2022", me fond limit 1,733,333.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 30-03-2026, nga autoriteti kontraktor, Identitek Sh.a.

II.2. Në datën 30-03-2026 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt-ankimi.

II.3. Më datë 20.04.2026 autoriteti kontraktor ka kryer vlerësimin e ofertave si vijon:

1."LACONICS"SHPK	1,167,400.00	skualifikohet,
2."FIRST"SHPK	1,442,667.00	Kualifikohet,
3."iCom"SHPK	0	Skualifikuar,
4."SINTEZACO"SHPK	0	Skualifikuar
5."SOHOSOLUTIONS"SHPK	1,299,999.75	Skualifikuar
6."Pentaquark"SHPK	1,475,000.00	Skualifikuar
7."ENetCom"SHPK	1,658,000.00	Skualifikuar

II.4. Në datën 23.04.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar njoftim fituesin, si dhe skualifikimin e operatorit ekonomik ankimues në këtë procedurë prokurimi me argumentin si më poshtë vijon:

“Pas një procesi vlerësimi të detajuar, nga verifikimet e kryera, KVO është e mendimit që dokumentacioni i paraqitur nga ky operator nuk plotëson kriterin e kërkuar mbi punët e ngjashme, për arsyet e mëposhtme: • Dokumentacioni i paraqitur (përfshirë faturat dhe referencat) nuk ofrojnë evidencë të mjaftueshme dhe të verifikueshme që demonstrojnë përfshirje në auditime në përputhje me standardin ISO/IEC 27001; • Nuk është konfirmuar në mënyrë të qartë dhe të pavarur roli specifik si auditor në kuadër të proceseve të auditimit sipas deklaratës (p.sh. auditim certifikues nga organ i akredituar ose auditim i brendshëm formal i ISMS); • Informacioni i disponueshëm nuk demonstrojnë në mënyrë bindëse eksperiencë të mëparshme të mjaftueshme dhe relevante në auditime të lidhura drejtpërdrejt me ISO/IEC 27001; • Nga verifikimet e kryera mbi palët e përfshira, nuk është arritur të konfirmohet lidhja e pretenduar midis angazhimeve të deklaruara dhe proceseve të mirëfillta të certifikimit ISO/IEC 27001. • Bazuar edhe në Certifikatën e lëshuar nga CERTIS për Lead Auditor Standardi ISO 27001:2022 me datë lëshimi më 23.03.2026, nuk vërtetohet që ka kryer punë të ngjashme të mëparshme dhe si pasojë nuk përmbush kriterin nr. 2.3.1 kapaciteti teknik. Bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar, kërkohet ky kriter që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, si dhe Operatori ekonomik duhet të dëshmojë kompetencën dhe certifikimi i tij si Lead Auditor,

demonstron aftësitë e tij për të planifikuar, kryer dhe raportuar auditime të plota të ISMS duke mbuluar rreziqe dhe procese thelbësore për një audit të brendshëm efektiv. Pa këto kompetenca auditit i brendshëm rrezikon të mos jetë i mjaftueshëm duke rrezikuar kështu certifikimin e jashtëm apo moszbatim të Klauzolës 7.2 të ISO27001:2022 (kompetenca). Certifikimi si Lead Auditor është praktike standarde e organizatave për të dokumentuar kompetencat si auditues i brendshëm. Operatori SOHO SOLUTION SHPK, e ka paraqitur këtë certifikatë, por kjo vërteton që ai nuk ka kryer punë të mëparshme si i tillë. Ky vendim është marrë në përputhje me kërkesat për transparencë, objektivitet dhe verifikueshmëri të përvojës profesionale, të nevojshme për 2 ushtrimin e rolit të Auditorit ISO/IEC 27001. Për këto arsye, operatori ekonomik “SOHO SOLUTIONS” SHPK nuk kualifikohet.”

II.5. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, Komisioni i Prokurimit Publik, ka administruar ankesën me nr. A/2026/6579, datë 24.04.2026 dhe nr. Protokolli 1262/2026, datë 24.04.2026, të operatorit ekonomik “SOHO SOLUTIONS” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-79360-03-17-2026, me objekt: “Auditim i Brendshëm i ISMS sipas Standartit ISO 27001:2022”, me fond limit 1,733,333.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 30.03.2026, nga autoriteti kontraktor, Identitek Sh.a.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit me Nr. 1262/1 Prot datë 27.04.2026, në lidhje me kundërshtimin e arsyeve të skualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “SOHO SOLUTIONS” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit objekt ankimi.

II.7. Me shkresën e datës 24.04.2026, protokolluar me tonën me nr. 1262/2 prot datë 27.04.2026, të dërguar nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave është depozituar nga operatori ekonomik ankimues në Komisionin e Prokurimit Publik, formulari i ankesës lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit në rrugë postare.

II.8. Me shkresën nr. 552/8 prot, datë 05.05.2026, protokolluar me tonën me nr. 1262/3 prot, datë 07.05.2026, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe informacioni për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “SOHO SOLUTIONS” SHPK, në të cilin konstatohet, se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk i ka pranuar pretendimet e ngritura nga ankimuesi në ankesë.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të kërkesës së operatorit ekonomik ankimes,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatori ekonomik “SOHO SOLUTIONS” SHPK mbi kundërshtimin e arsyes së skualifikimit të ofertës së tij, të dhënë nga komisioni i vlerësimit të ofertave si në vijim: *“Në vijim të mesazhit të refuzimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, sipas të cilit Dokumentacioni i paraqitur (përfshirë faturat dhe referencat) nuk ofrojnë evidencë të mjaftueshme dhe të verifikueshme që demonstroi përfshirje në auditime në përputhje me standardin ISO/IEC 27001 , theksohet se ky konstatim është i pabazuar në kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe përbën një interpretim të gabuar të kriterit të përvojës së ngjashme, duke vendosur në mënyrë të paligjshme një standard shtesë gjatë fazës së vlerësimit. Në përputhje me pikën 2.3.1 Kapaciteti teknik të dokumenteve të tenderit, operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbime të mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më pak se 20% e fondit limit, të cilat provohen përmes faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e shërbimeve të realizuara. Në rastin konkret, kur shërbimet janë realizuar me subjekte private, dokumentet e tenderit nuk kërkojnë asnjë informacion shtesë përtej faturës tatimore të shitjes së rregullt. Operatori ekonomik SOHO SOLUTIONS shpk ka përmbushur plotësisht këtë kërkesë, duke paraqitur faturën tatimore nr. 6/2025, me vlerë 1,000,000 (një milion) lekë, si dhe faturën tatimore nr. 7/2025, me vlerë 1,470,000 (një milion e katërqind e shtatëdhjetë mijë) lekë, të cilat përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara ligjore dhe janë të deklaruara në sistemin fiskal. Të dyja këto fatura janë të datuara brenda periudhës 3-vjeçare të kërkuar nga dokumentet e tenderit dhe përmbushin plotësisht kushtin kohor të përcaktuar në kriter. Në lidhje me vlerën e kërkuar minimale, duke qenë se fondi limit i procedurës është 1,733,333 lekë, vlera minimale prej 20% për përvojë të ngjashme rezulton në rreth 346,666 lekë. Në këtë kuadër, fatura nr. 6/2025, me vlerë 1,000,000 lekë, përfaqëson rreth 57.7% të fondit limit, ndërsa fatura nr. 7/2025, me vlerë 1,470,000 lekë, përfaqëson rreth 84.8% të fondit limit, duke tejkaluar ndjeshëm pragun minimal të kërkuar. Për rrjedhojë, kriteri i vlerës është përmbushur plotësisht dhe në mënyrë të qartë. Sa i përket sasive të shërbimeve të realizuara, ato janë të reflektuara në mënyrë të plotë në faturat përkatëse dhe janë lehtësisht të verifikueshme në dokumentacionin e paraqitur, konkretisht në Shtojcën 1 Fatura nr. 6/2025 dhe Shtojcën 2 Fatura nr. 7/2025. Përtej kërkesave minimale të dokumenteve të tenderit, operatori ekonomik ka paraqitur edhe një deklaratë të detajuar për përshkrimin e shërbimeve të ngjashme, e bashkëlidhur si Shtojca 3 Deklaratë për përshkrimin e shërbimeve të ngjashme , në të cilën janë shpjeguar në mënyrë të qartë dhe të strukturuar natyra*

dhe përmbajtja e shërbimeve të realizuara. Në këtë deklaratë është theksuar gjithashtu se shoqëria jonë mbetet e gatshme që, me kërkesë me shkrim nga autoriteti kontraktor, të vërë në dispozicion vërtetime realizimi nga subjektet private përkatëse që kanë përfituar shërbimet. Në këtë kontekst, duhet theksuar se autoriteti kontraktor nuk ka kërkuar asnjë sqarim shtesë nga ofertuesi në zbatim të nenit 92 të ligjit nr. 162/2020 Për prokurimin publik , pika 1, megjithëse kishte mundësinë ligjore për ta bërë këtë, nëse e konsideronte të nevojshme për një vlerësim sa më të drejtë të ofertës. Mosushtimi i kësaj të drejte dhe kalimi i drejtpërdrejtë në skualifikim, pa kërkuar sqarime për dokumentacionin e paraqitur, përbën një vlerësim jo të plotë dhe jo proporcional të ofertës. Në referim të nenit 77 të ligjit nr. 162/2020 Për prokurimin publik , pika 1, kërkesat për kualifikim duhet të kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme dhe proporcionale me objektin e kontratës, si dhe duhet të kenë lidhje të drejtpërdrejtë me të. Në këtë rast, kërkesa për të provuar përfshirje në auditime specifike sipas standardit ISO/IEC 27001 nuk është pjesë e kriterit të shpallur dhe për rrjedhojë nuk mund të përdoret si bazë për vlerësimin apo skualifikimin e ofertës. Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik është i plotë, i verifikueshëm dhe përmbush në mënyrë të qartë dhe të matshme të gjitha kërkesat e përcaktuara në pikën 2.3.1 të dokumenteve të tenderit. Çdo interpretim që tejkalon këto kërkesa përbën vendosje të një kriteri shtesë gjatë fazës së vlerësimit, në kundërshtim me ligjin dhe me parimet themelore të prokurimit publik, dhe si i tillë nuk mund të qëndrojë si bazë për skualifikimin e operatorit ekonomik. Argumenti 3. Në vijim të mesazhit të refuzimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, sipas të cilit Nuk është konfirmuar në mënyrë të qartë dhe të pavarur roli specifik si auditor në kuadër të proceseve të auditimit sipas deklaratës (p.sh. auditim certifikues nga organ i akredituar ose auditim i brendshëm formal i ISMS) , theksohet se ky konstatim është i pabazuar në kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe përbën një interpretim të zgjeruar dhe të paligjshëm të kriterit të përvojës së ngjashme. Nga shqyrtimi i dokumenteve standarde të tenderit rezulton qartë se, në pikën 2.3.1 Kapaciteti teknik , kërkohet vetëm paraqitja e dëshmive për shërbime të mëparshme të ngjashme, të vërtetuara përmes faturave tatimore të shitjes të plotësuara sipas legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara. Në asnjë pjesë të dokumenteve të tenderit nuk kërkohet që operatori ekonomik të provojë ushtrimin e një roli të formalizuar si auditor në kuptimin e një procesi certifikimi, apo që auditimi të jetë realizuar nga një organ i akredituar, apo që të provohet pjesëmarrja në një auditim formal të një sistemi ISMS sipas standardit ISO/IEC 27001. Për rrjedhojë, kërkesa e bërë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave për të konfirmuar në mënyrë të qartë dhe të pavarur rolin specifik si auditor nuk buron nga kriteret e shpallura në dokumentet e tenderit, por përbën një standard të ri të vendosur gjatë fazës së vlerësimit, i cili nuk ka qenë i njohur për operatorët ekonomikë në momentin e përgatitjes dhe dorëzimit të ofertave. Nga ana tjetër, operatori ekonomik SOHO SOLUTIONS shpk ka paraqitur dokumentacion të plotë, duke përfshirë faturat tatimore dhe një deklaratë të detajuar për përshkrimin e shërbimeve të realizuara, në të cilën evidentohet qartë përfshirja në procese të analizimit, auditimit dhe përmirësimit të sistemeve të informacionit. Këto aktivitete përfshijnë analizimin e arkitekturës së sistemeve, identifikimin e problematikave, hartimin e raporteve të

auditimit dhe implementimin e masave për përmirësimin e sigurisë dhe performancës, çka përbën në thelb veprimtari auditimi dhe vlerësimi teknik të sistemeve të informacionit.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 7 “Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit” pika 2.3.1 “Kapaciteti teknik” autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues si më poshtë vijon:

“2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit**. Këto shërbime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
 - a. Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.
 - b. Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.”.

III.1.2. Në shtojcën 6 “FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE” në dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar llojin dhe sasinë e produkteve objekt prokurimi, si më poshtë vijon:

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent”.

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

III.1.3. Në shtojcën 8 autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues si më poshtë vijon:

TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: “Auditim i brendshëm i ISMS sipas Standardit ISO 27001:2022”.

Konsulenca do të konistoj në pikat më poshtë:

Kërkesat që duhen plotësuar për shërbimin, Auditim i brendshëm i ISMS sipas Standardit ISO 27001:2022, janë:

- a) Kompania duhet të dorëzojë një listë të dokumenteve që do të kërkojë për kryerjen e Auditit të Brendshëm për Certifikimin ISO 27001.*
- b) Kompania të rishikojë dokumentet ekzistuese të IdentiTek dhe të japë opinionin e tij në lidhje me vlefshmërinë e tyre në kuadër të Standardit.*
- c) Kompania të bëjë një “gap-analysis” të dokumenteve ekzistuese dhe atyre që janë të nevojshme për t’u hartuar ose përditësuar.*
- ç) Kompania të ketë pjesëmarrje aktive 3(tre) ditë gjatë procesit të auditimit.*
- d) Audituesi përfaqësues i pomanisë të dëshmojë eksperiencën të mëparshme pune dhe të ketë minimalisht “Lead Auditor” ose ekuivalente CISA*

dh) Kompania të udhëzojë dhe të orjentojë me shkrim për zgjidhjen e gjetjeve procesit të auditit.

e) Kompania të kryejë një auditim të mekanizmave të monitorimit dhe vlerësimit në përputhshmëri absolute me Standardin ISO 27001:2022 (Monitoring and Evaluation).

ë) Kompania të kryejë një audit të brendshëm të plotë të përputhshmërisë së Anekseve dhe klauzolave të Standardit ISO 27001:2022.

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve: Pranë ambjenteve të zyrave Qendrore të "Identitek" SHA.

Auditimi i brendshëm kryhet me frekuencë vjetore. Kontrata ka një kohëzgjatje prej 1 (një) muaji, periudhë gjatë së cilës finalizohen të gjithë elementet e shërbimit, përfshirë dhe auditimin fizik, i cili zgjat mesatarisht rreth 3 (tre) ditë.

III.1.4. Në përmbushje të kriterit të mësipërm, operatori ekonomik "SOHO SOLUTIONS" shpk ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), dokumentacionin si më poshtë:

- Faturë tatimore shitje elektronike nr. 7/2025, datë 31.12.2025, me shitësit shoqërinë "SOHO SOLUTIONS" shpk dhe blerës subjektin Musa Coha, me objekt: "Zhvillimi i Backend-it dhe Bazes se te dhenave, App dhe Zhvillimi i Frontend-it (Android & iOS), App.", me vlerë 1 470 000,00 leke pa TVSH.
- Faturë tatimore shitje elektronike nr. 6/2025, datë 31.12.2025, me shitësit shoqërinë "SOHO SOLUTIONS" shpk dhe blerës subjektin Musa Coha, me objekt: "Arkitektura app vlerë monetare", me vlerë 1 000 000,00 leke pa TVSH.

-Gjithashtu operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar:

- certifikaten me përshkrimin "Mori pjesë në testimin për profesionin: Lead Auditor Standarti Iso 27001:2022 organizuar nga CERTIS, në Tiranë më : 23 mars 2026 " nr. CO12622026 me datë lëshimit: 23 mars 2026, dhe datë skadimi: 23 mars 2029.
- Deklaratë për përshkrimin e shërbimeve të ngjashme me përmbajtje ndër të tjera "...Në bazë të faturës nr. 6/2025, shoqëria ka realizuar shërbimin me objekt "Arkitektura app", i cili ka konsistuar në analizimin dhe auditimin e arkitekturës ekzistuese të sistemit informatik, duke përfshirë rishikimin e dokumentacionit ekzistues dhe dhënien e opinionit profesional mbi vlefshmërinë e tij. Në kuadër të këtij shërbimi është kryer identifikimi i problematikave në arkitekturë, vlerësimi i funksionaliteteve ekzistuese dhe i mekanizmave të monitorimit, si dhe një analizë e diferencave ndërmjet gjendjes aktuale dhe kërkesave për përmirësim. Në përfundim, është hartuar raporti i auditimit dhe monitorimit, si dhe projekti për përmirësimin e arkitekturës së sistemit, duke përfshirë edhe shtimin e funksionaliteteve të reja të një sistemi informatik në shërbim të edukimit.

Në vijim të këtij procesi, në bazë të faturës nr. 7/2025, shoqëria ka realizuar zhvillimin dhe implementimin e plotë të sistemit informatik, duke përfshirë zhvillimin e backend-it, të bazës së të dhënave dhe të frontend-it për aplikacione Android dhe IOS. Ky shërbim ka konsistuar në implementimin e logjikës së biznesit, integrimin e sistemeve dhe mekanizmave të sigurisë, si dhe në zbatimin e projektit të hartuar për korrigjimin e problematikave të identifikuara gjatë auditimit të arkitekturës dhe për shtimin e funksionaliteteve të reja. Në këtë mënyrë është siguruar përmirësimi i strukturës, performancës dhe sigurisë së sistemit.

Për shkak të konfidencialitetit ndërmjet palëve, kontratat e shërbimit nuk mund të vihen në dispozicion. Megjithatë, shoqëria jonë mbetet e gatshme që, me kërkesë me shkrim nga autoriteti kontraktor, të vërë në dispozicion vërtetime realizimi nga subjektet përkatëse private që kanë përfituar shërbimet...”

III.1.5. Në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim” pika 4 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

“4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.1.6. Neni 41 pika 3 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, e VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

“3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të

vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.”.

Ndërsa në nenin 92/3 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.1.7. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” i ndryshuar ka për detyrë të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e

prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.1.8. Sqarojmë, se referuar rregullave të prokurimit publik, për kontratat e shërbimeve, për të provuar përvojën e ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë parashikimet e përcaktuara në nenin 41, pika 3 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, ku për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës dhe për të gjykuar në lidhje me përmbushjen apo jo nga ana e operatorit ekonomik “SOHO SOLUTIONS” SHPK të kriterit më sipër lidhur me përvojën e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit. Për përmbushjen e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.1 të kapacitetit teknik të dokumenteve standarde të tenderit, për përvojë të ngjashme të kryer gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur dokumentacionin e cituar në pikën III.1.4. të këtij vendimi. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistem nga operatori ekonomik “SOHO SOLUTIONS” SHPK për të dëshmuar përvojën e mëparshme të ngjashme të kryer gjatë tre viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, KPP gjykon të ndalet në një analizë të thelluar të dëshmive të eksperiencës së ngjashme të dorëzuar nga ankimuesi, parë kjo në rrafshin krahasimor me shërbimet e hartuar nga autoritetit kontraktor, për sa i përket 3 komponentëve, si komponenti kohë (ku Komisioni për këtë komponent do të marrë në konsideratë ato kontrata të cilat janë brenda afatit kohorë 3 vjeçar nga data publikimit të njoftimit të kontratës), komponenti vlerë (lidhet me madhësinë e kontratës ose kontratave të kërkuara nga autoriteti kontraktor në kriterin 2.3.1 pra shërbime të mëparshme të ngjashme ku vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës) si dhe komponentit natyrë e ngjashme (i cili lidhet me natyrën e ngjashme të kontratave të dorëzuara nga ankimuesi me objektin e prokurimit nisur jo vetëm nga emërtesa e kontratës por edhe nga zërat e preventivave të tyre). Gjithashtu, me akt nënligjor, diskrecioni i vendosur nga ligji është rregulluar edhe më tej, ku në rastin e kontratave të shërbimeve, ligjvënësi në nenin 41, pika 3 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, ka parashikuar, mënyrën se si ky kriter përmbushet në rastin e përvojës së ngjashme të mëparshme të realizuar me sektorin publik apo me sektorin privat. Duke iu kthyer kriterit, KPP konstaton, se kriteri i hartuar nga ana e autoritetit kontraktor është në përputhje me diskrecionin e dhënë nga ligji dhe akti nënligjor, afati i kërkimit të dokumentacioni është brenda periudhës 3 vjeçare si dhe vlera e kërkuar është brenda kufijve të vlerës sikundër parashikohet edhe në VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Në këtë kuadër siç është cituar më sipër në këtë vendim. KPP nga shqyrtimi dhe verifikimi i të gjitha elementeve të kontratave të dorëzuara nga ankimuesi për përmbushjen e kriterit për përvojën e mëparshme të ngjashme, duke nisur që nga objekti i tyre, vërtetimi i realizimit, përshkrimi i shërbimeve në faturë tatimore si pjesë përbërëse e kontratave, si dhe afatit të realizimit të tyre, nga të gjitha

dokumentet e dorëzuara në sistemin e prokurimeve elektronike nga operatori ekonomik për vërtetueshmërinë e përmbushjes së kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.1 të kapacitetit teknik të dokumenteve standarde të tenderit, mori në shqyrtim këto kontrata:

- Faturë tatimore shitje elektronike nr. 7/2025, datë 31.12.2025, me shitësit shoqërinë *“SOHO SOLUTIONS” shpk dhe blerës subjektin Musa Coha, me objekt: “Zhvillimi i Backend-it dhe Bazes se te dhenave, App dhe Zhvillimi i Frontend-it (Android & iOS), App.”*, me vlerë 1 470 000,00 leke pa TVSH.
- Faturë tatimore shitje elektronike nr. 6/2025, datë 31.12.2025, me shitësit shoqërinë *“SOHO SOLUTIONS” shpk dhe blerës subjektin Musa Coha, me objekt: “Arkitektura app vlerë monetare”*, me vlerë 1 000 000,00 leke pa TVSH.

Komisioni Prokurimit Publik do të marrë në shqyrtim në themel dokumentet e sipërcituara, pasi ato i përmbushin të tre komponentët, pra si komponentin vlefshmëri (për ato fatura ose zëra të tyre që janë brenda afatit tre vjeçar nga data e publikimit të njoftimit të kontratës) si komponentin ngjashmëri (që kanë objekt apo zëra të ngjashëm në faturat e dorëzuara) dhe si komponentin e vlerës së realizuar. Komisioni i Prokurimit Publik, pasi veçoi dokumentacionin e sipërcituar, i cili i përmbushin të tre komponentët që karakterizojnë një kontratë të ngjashme, pra elementin kohë, elementin vlerë dhe elementin ngjashmëri, vëren të ndalet në elementin ngjashmëri si arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik i cili me të drejt pretendon se për sa kohë objekti i faturës nr. 6/2025, me objekt "Arkitektura app", ka konsistuar në analizimin dhe auditimin e arkitekturës ekzistuese të sistemit informatik...Në përfundim, është hartuar raporti i auditimit dhe monitorimit, si dhe projekti për përmirësimin e arkitekturës së sistemit, duke përfshirë edhe shtimin e funksionaliteteve të reja të një sistemi informatik në shërbim të edukimit, ashtu si dhe objekti i faturës nr. 7/2025 përfshinë zhvillimin e backend-it, të bazës së të dhënave dhe të frontend-it për aplikacione Android dhe iOS dhe shërbim ka konsistuar ndër të tjera dhe në zbatimin e projektit të hartuar për korrigjimin e problematikave të identifikuara gjatë auditimit të arkitekturës dhe për shtimin e funksionaliteteve të reja, sjellë përmbushje të elementit ngjashmëri.

Përsa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues *“SOHO SOLUTIONS” SHPK* qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 *“Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”*, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “SOHO SOLUTIONS” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-79360-03-17-2026, me objekt: “Auditim i Brendshëm i ISMS sipas Standartit ISO 27001:2022”, me fond limit 1,733,333.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 30-03-2026, nga autoriteti kontraktor, Identitek Sh.a.
2. Autoriteti kontraktor të rivlersojë ofertën e operatorit ekonomik “SOHO SOLUTIONS” SHPK sipas konstatimeve të vendimit të mësipërm të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “SOHO SOLUTIONS” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Tërnova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

